

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.XH. nga fshati ..., komuna e Vitisë, për shkak se ka kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par 9 lidhur me par. .1, të Kodit Penal të Republikës të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.552/2014 datë 14.08.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.552/2014 datë 14.08.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.552/2014 datë 14.08.2018, i akuzuari S.XH., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par 9 lidhur me par. .1, të KPRK-së, për të cilën është gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1(një) viti, ashtu që dënimi i shqiptuar nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale. I akuzuari është obliguar ti paguaj gjykatës shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t'ia kthej në rigjykim dhe rivendosje, nga se i njëjti është marr me për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP-së apo të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të akuzuarit dënimin e kushtëzuar t'ia zëvendësoj me dënim me burg efektiv, i cili dënim do të ishte proporcional me mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore, po ashtu një dënim me burgim efektiv do të ndikonte pozitivisht në riedukimin e tij dhe të tjerëve që të mos kryejnë vepra penale, e mbi të gjitha do të arrihej edhe zhvillimi i përgjegjësisë shoqërore dhe i risocializimit të qytetarëve

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim, PPA/II.nr.1173/18, datë 30.11.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar sa i përket vendimit mbi dënimin dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura ne ankesë.

Prokurori me ankesë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimi të ankimuar është i pa qartë, i pa kuptueshëm dhe si i tillë, i pa zbatueshëm, pasi që nuk mund të kuptohet se çfarë dënimi i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë të akuzuarit, dënim burgu në kohëzgjatje prej 180 ditësh apo 1vit me kusht që në afatin e lënë prej dy viteve të mos kryejë vepër tjetër penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e lartë cekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPPK-së për të cilat pretendohet në ankesë, apo shkelje të tjera të cilat gjykata e shkallës së dytë në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së i vëren detyrimisht, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Kështu, me aktgjykimin e ankimuar, pra edhe dispozitivi i tij është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, nuk përmban kundërthënie me vetveten ose me arsyet e paraqitura. Pretendimi i Prokurorit se nga aktgjykimi i ankimuar nuk mund të kuptohet se çfarë dënimi i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë të akuzuarit, dënim burgu në kohëzgjatje prej 180 ditësh apo 1vit me kusht që në afatin e lënë prej dy viteve të mos kryejë vepër tjetër penale, nuk qëndron ngase bazuar në aktgjykimin e ankimuar i akuzuari S.XH., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par 9 lidhur me par .1, të KPRK-së, për të cilën është gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 180 ditësh, ashtu që dënimi i shqiptuar nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale mirëpo e njëjta gjykatë me Aktvendimin, P.nr. 552/2014 të datës 18.09.2018 ka bërë përmirësimin e aktgjykimit të ankimuar pikërisht ku është e shkruar “e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 180 ditësh” duhet të jetë “ me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 viti” ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimit ka mbetur e pa ndryshuar. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se me përmirësimin e aktgjykimit të ankimuar, i njëjti është i qartë dhe i qëndrueshëm.

Sipas ankesës, Prokurorja, pretendon se Gjykata e shkallës së parë nuk ia ka shqiptuar të akuzuarit dënimin e merituar sipas ligjit pasi që për veprën penale për të cilën është akuzuar S.XH. të njëjtit i ka shqiptuar dënim tejet të ulët, të njëjtin madje edhe e ka kushtëzuar edhe për kundër faktit se me dispozitën ligjore nga neni 365 par.9 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në mënyrë dicidive është paraparë dënimi me burg prej 1 deri në 8 vite, se nuk cekë asnjë rrethanë konkrete por vetëm i parafrazon të njëjtat ndërsa rrethana lehtësuese çfarëdo qofshin ato asesi në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohen se janë të asaj rëndësie që të ndikonin në shqiptimin e këtij dënimi. Sipas ankesës gjykata e shkallës së parë si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij, faktin se është prind i dy fëmijëve, moshën e tij të re, si dhe faktin se i akuzuari tani të ndjerin A.XH. e kishte familjarë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata kinse ka marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore nga ankesa e Prokurorit, janë të pa bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me dispozitat e nenit 73 të KPRK, duke i vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin se i akuzuari S.XH. ka pranuar fajësinë, është prind i dy fëmijëve, i moshës së re, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar faktin se fëmijën tani të ndjerë A.XH. e kishte familjarë në vijë të drejtë të gjakut dhe se kjo tragjedi të njëjtin e ka prekur aq shumë saqë çfarëdo dënimi që ti ipet, nuk do të arrijë ta fshijë nga memoria e të akuzuarit përjetimin dhe dhimbjen e ndier. Gjykata e shkallës së parë si rrethanë tjetër lehtësuese ka vlerësuar edhe deklaratën e prindërve të fëmijut të ndjerë të dt. 28.08.2014 me të cilën deklaratë kanë kërkuar nga gjykata që i akuzuari S.XH. mos të dënohet, respektivisht të mos ndiqet penalisht si dhe nuk kanë parashtruar asnjë kërkesë materiale dhe jo materiale nga tani i akuzuari, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të lartcekura dhe se në ankesën e Prokurorit nuk theksohet asnjë rrethanë lehtësuese e cila nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë e që do të ndikonte në ashpërsimin e dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe drejt vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe faktin se nga kryerja e veprës penale kanë kaluar më tepër se 4 vite, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Nga sa u tha më lartë në pajtim më dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
PA1.nr.1169/18 me 18.12.2018

Bashkëpunëtori profesional
Jeton Leci

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi

3. Afrim Shala